



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 94-të të mbajtur më 13.10.2023, ka miratuar sa vijon.

VENDIM

Denoncimi i paraqitur me numër 12-2731/1 datë 06.05.2023, bazuar në kopjen e kallëzimit penal të dorëzuar në Prokurorinë Publike Themelore për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent, duke pasur parasysh se raporti i është dorëzuar autoritetit kompetent.

Lënda me numër 12-2731/1 nga 05.06.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Një parashtrues i njohur, më 06.05.2023, ka dorëzuar një kopje të një kallëzimi penal të dorëzuar në Prokurorinë Publike të /// dhe është konstatuar rasti me numër 12-2731/1, datë 06.05.2023.

parashtruesi thekson se në shtojcë paraqet kallyimin penal që është pranuar në /// me datë 29.05.2023. E njëjta është paraqitur kundër anëtarëve të Komisionit të Provimit të Pranimit, anëtarëve të Bordit Drejtues, drejtorit dhe zëvendës drejtorit të -----
----- dhe është dorëzuar në lidhje me shpalljen publike për pranimin e kandidatëve për trajnim fillestar në ----- për dëgjuesit e brezit IX.

Pas shqyrtimit të pretendimeve përkatëse dhe të bashkëngjitjeve të dorëzuara, KSHPK-ja ka konstatuar se parashtruesi denoncimin ia ka dorëzuar organit kompetent - prokurorisë publike, pas së cilës ka vlerësuar se nuk ka elemente për veprim kompetent në rastin në fjalë dhe ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Dorëzuar: parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B:K:SH

Miratoi: Mr. V.G., Anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**
Kryetar,
Biljana Ivanovska

